Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguer e

RILINDJA

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО:
ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DEL DY HERE NE JAVE:
T'EJTEN DHE TE DIELLEN

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

Vjeti IV Nr. 147 | PRISHTINE, e diele 26 Shtatuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

Duhet me e permiresue punen per perfshimjen e fuqis se re puntore n'ekonomi

Ne Krahinen t'one jane tue vazhdue punime te mdha investimi per ngritjen e objekteve te ndryshme si dhe punime te tjera te parapame me Planin pesvjeçar, te cilat kerkojne nji numer te madh puntoresh te kualifikuem e te pakualifikuem. Per kete qellim asht ndermarre nji akcion i gjane per perfshimjen e fuqis se re puntore n'ekonomi. Mirepo, plani i parapame nuk asht tue u-realizue ne shumicen e rretheve te Krahines s'one. Plani i muejit gusht asht realizue vetem ne dy-tri rrethe, si p. sh. ne Mitrovice, Podujeve e Gjakove, kurse n'asnji rreth tjeter nuk ka pase perfundime te knaqeshme.

Ne gjysmen e pare te shtatorit plani asht realizue vetem ne rrethin e Liplanit (200 per qind), ne rrethin e Ferizajt (100 per qind) dhe n'ate te Gjakoves (95 per qind). Ne rrethet tjera plani asht realizue me nji perqindje te vogel. Per shembull ne rethin e Gjurakovcit asht realizue vetem me 4 per qind, ne rrethin e Rahovecit me 8 per qind, n'ate te Kamenices me 12 per qind, te Pejes me 20 per qind etj.

Tue e marre punen ne tanesi per mbare Krahinen, konstatohet se nuk asht tue u-plotesue ende plani i perfshimjes se fuqis puntore n'ekonomi. Kjo rrjedhe ne rend te pare nga mos-angazhimi i duhun i drejtorinave perkatese te rretheve, nga agjitacioni i dobet, nga ndihma e pamjaftueshme e keshillave ekzekutive te rretheve dhe e organizatave masovike. Komisjonet e formueme prane keshillave te vendeve egzistojne vetem ne leter.

Mandej punen per inkuadrimin e fuqis se re puntore n'ekonomi e kane pengue edhe vete sipermarrjet, te cilat s'jane kujdesue aq sa duhet per pranimin, vendosjen dhe furnizimin e mire te puntorve. Ne te shumten, sipermarrjet kane punue pa plan, nuk jane perpjeke per transportimin me kohe te puntorve, çka ka shkatue shperndamjen e tyne dhe, nuk i dergojne perfaqesuesit e tyne ne terren, te cilet jane shum te nevojshem si per agjitacion ashtu edhe per pranimin e kujdesimin rreth puntorve. Vetem sipermarrja „Trepça" kujdesohet me kohe rreth te gjitha ketyne problemeve. Ne disa sipermarrje ka ngja qe puntoret te largohen nga puna per shkak te konditave te keqija te jeteses dhe per shkak te mos-kujdesimit per 'ta, si nga ana e drejtoris se sipermarrjes, ashtu dhe nga ana e deges sindikale.

Disa sipermarrje nuk i kane siguruе vendet e banimit. Per shembull sipermarrja pyjore »Rugove« ne Peje ka kerkue ne muejin gusht nji numer mjaft te madh puntoresh e nuk ka pase ku me e vendose as nji te shtaten e puntorve te kerkuem, te cilet mbas pak ditesh jane kthye neper shtepijat e veta. Mirepo, sipermarrja ne fjale ka fillue me nji here me ndertue baraka te pershtatshme, ku asht vendose dhe do te vendoset nji numer i madh puntoresh. Edhe gjate ketij mueji ka ndodhe qe puntoret te largohen nga puna e disa sipermarrjeve per mungese vend banimesh dhe per shkak te furnizimit te dobet. Per shembull ne sipermarrjet e Prizrenit etj. puntoret nuk furnizohen rregullisht me cingare, vaj, sheqer, peme etj.

Me daten 20 te ketij mueji nji grup prej ma se 60 puntoresh nga keshilli i vendit Strellc i rrethit te Pejes, ishte thirre nga drejtorija e rrethit dhe do te nisej per ne sipermarrjen „Vologja" te Malit te Zi. Per mungese mjetesh transportit, drejtoija e rrethit e nisi ket grup puntoresh per ne hekurudhen Metohi - Prizren. Mirepo, nga moskujdesimi i drejtoris se rrethit, puntoret mbeten te sillen gjithe diten neper qytet dhe, shumica e tyne u-kthyen per ne shtepijat e veta, keshtu qe ne mbramje u-nis nji numer krejt i vogel per ne vendin e caktuem.

Per te muejte me e realizue e bile edhe me e tejkalue planin e perfshimjes se fuqis puntore n'ekonomi, asht e nevojshme qe sipermarrjet te kujdesohen ma teper per kushtet jetesore te puntoreve dhe te bashkepunojne ngushte me drejtorit' e rretheve. N'anen tjeter, duhet te permiresohet sa ma shum puna ne shumicen e rretheve t'ona. Drejtorite perkatese duhet te punojne ma me plan dhe te koordinohet puna ne mes te tyne, keshillave popullore te rretheve dhe organizatave masovike, ne menyre qe te mos mungoje asnjihere ndihma reciproke.

Me zhdukjen e te metave te siperme do te realizohet me siguri plani i parapame dhe do te korren suksese te mira per çdo rreth, mbassi nji numer i madh katundaresh t'one dishron me hy ne pune neper sipermarrjet t'ona ekonomike.

Realizimi i planit per inkuadrimin e fuqis puntore n'ekonomi asht detyre qe mundet dhe duhet te plotesohet.

Pregaditjet e kryeme me kohe do te sigurojne zhvillimin me plan te mbjelljeve te vjeshtes

Ne keto dite ka fillue mbjellja e tershanes ne rrethin e Suharekes, Prizrenit, Pejes dhe pjeserisht n'ate te Prishtines. Kooperativat bujqesore te punes jane tue i krye pregaditjet e fundit per fillimin e fushates se mbjelljeve. Nga rrethet tjera nuk disponohen ende shenime rreth fillimit te mbjelljeve. Ne mbare Krahinen asht tue vazhdue puna rreth perpunimit te planeve, rreth korigjimit dhe plotesimit te tyne ne lidhje me shtimin e siperfaqeve te disa kulturave.

Puna rreth blemjes se fares asht shpejtesue. Plani i blemjes se fares nuk asht realizue ende vetem ne rrethin e Prishtines dhe te Liplanit per shkak t'angazhimit te pamjaftueshem te drejtorinave per blemje, per mungese lokalesh dhe ambalazhi. Fara e grozhles dhe qiqrres per ushqimin e bagtis nuk asht ble ne shumicen e rretheve. Fshimja e ketyne dy kulturave ka fillue tash vone, keshtu qe mundet me ndikue mjaft ne realizimin e planit te mbjelljeve te ketyne kulturave.

Bashke me pregaditjet tjera duhet te kryhet edhe pastrimi e plubnimi i fares. Kesaj çashtjeje nuk i asht kushtue ende kujdes i duhun. Simbas shenimeve jo te plota jane pastrue deri tash 4 per qind e jane plubnue 2 per qind te fares se grunit, vetem 1 per qind te fares s'elbit dhe te thekres dhe 16 per qind te tershanes.

Kerkesat per fare nuk jane ba me kohe nga te gjitha keshillat e rretheve. Keshilli i qytetit ne Prishtine ka njoftue njihere se nuk ka nevoje per fare, e me 22 te ketij mueji ka paraqite prap kerkesen e vet per fare. Ne shumicen e rretheve kerkesat jane ba reale e tash jane ndreqe edhe n'ato rrethe ku ma pare kane qene jo te sakta.

Tue i çfrytezue eksperiencat e fushatave te kalueme te mbjelljeve, si dhe mundesit'e reja qe jane krijue e qe krijohen vazhdimisht ne Vendin t'one, duhet te bajme çmos qe jo vetem t'a kryejme me sukses fushaten e mbjelljeve te sivjeme por edhe te luftojme per perparimin e bujqesis.

Organizatat e Partis dhe te Frontit popullor duhet t'apin ndihmen e vet te vazhdueshme per kryemjen me sukses te te gjitha detyrave te shtrueme me plan.

Sigurimi i rezervave t'ushqimit dhe i druve per stinen e dimnit

Sigurimi i rezervave t'ushqimit dhe i druve per njerzit punues, menzat internatet, spitalet, institutet etj., asht tash nji nga detyrat ma kryesore t'organeve te ngarkueme me furnizim. Per me muejte te'i sigurue me kohe rezervat e nduyshme t'ushqimit dhe te druve per stinen e dimnit, Drejtorati i tregtis i Keshillit Krahinuer ka dhane shpesh here udhezime si me shkrim ashtu dhe me anen e konferencave te thirruna t'organizueme per kete qellim. Para shum kohe ka qene shtrue detyra e perpilimit te planeve te nevojave per peme dhe perime, te cilat do t'i paraqite-hin Drejtoratit te tregtis ma se largti deri me 8 shtatuer. Mirepo, nji shumice rrethesh nuk i ka paraqite as deri me daten 23 te k. m. Keshillave te rretheve ne Gjurakove dhe ne Podujeve u-jane kthye planet per shkak se nuk i kane nda n'institute etj. Disa sipermarrje nuk e kane qene aq sa duhet randesin e sigurimit te ketyne rezervave dhe deri tash nuk kane marre kurrfare masash. Sipermarrja e ndertimeve „Graçanica" ka refuzue me i marre lakrat, specat, domatet etj. per mungese enesh per turshi etj.

Per sigurimin e sasis se nevojshme te druve asht perpilue plani qysh ne muejin fruer te ketij vjeti dhe u asht dhane sipermarrjeve te ndryshme, magazinave te rretheve e te qyteteve dhe bashkimeve kooperative te rretheve detyra e prodhimit. Bashke me planet jane dhane dhe udhezimet perkatese. Mirepo, deri tash vone nuk jane ba gadi kurrfare pregatitjesh me perjashtim te rrethit te Prizrenit, Rahovecit, Vuçiternes, Liplanit, ku asht pregatite nji far sasije drush. Magazines se rrethit „Novo Doba" t'Istokut i ka ra nder mend vone, vetem me 16 te k. m., per me pyet se ne çfare pyelli do te priten drute dhe ku do te merret leja perkatese. Detyret e prodhimit kane qene caktue per çdo sipermarrje dhe jane dhane udhezimet per lidhjen e kontratave per blemjen e druve. Keshtu per shembull sipermarrja „Granapi" e Prishtines e ka lidhe kontraten me bashkimin kooperativ te rrethit te Mitrovices, mirepo ky i fundit ne vend qe me ia dergue druve te „Granapit" te Prishtines ia ka shite nji sipermarrjeje tjeter ne Serbi. Me 21 gusht jane njoftue keshillat popullore qe t'i autorizojne sipermarrjet per lidhjet e kontratave me ekonomitet pyjore per blemjen e druve te rrezueme dhe te thata. Mirepo, edhe ne lidhje me kete nuk asht ba kurgja deri tash.

Me qellim qe t'organizohet sa ma mire sigurimi i rezervave te gjanave ushqimore dhe i druve, asht formue shtabi krahinuer. Per kete qellim do te formohen sa ma pare dhe shtabet prane keshillave te rretheve, te cilat do t'udhehiqen nga te besuemit e seksioneve te tregtis. Antare do te jene: udheheqsi i drejtoris per blemje, udheheqsi i drejtoris per furnizim, drejtori i sipermarrjes se grumbullimit, ose drejtori i sipermarrjes per furnizim, perfaqsuesi i sindikatave, i bashkimit kooperativ te rrethit dhe perfaqsuesit e organizatave masovike. Detyra e ketyne shtabeve asht qe te kujdesohen per organizimin sa ma te mire te punes per blemjen e artikujve te ndryshem, dhe per transportimin e tyne.

Para organeve te blemjes dhe para shtabeve perkatese shtrohet si detyre e shpejte dhe e randesishme çfrytezimi i te gjitha burimeve lokale. Garancija e sigurimit te rezervave t'ushqimit dhe te druve per stinen e dimnit asht perforcimi i organizatave te blemjes dhe afrimit i saje per t'i krye te gjitha detyret ne lidhje me plotsimin dhe tejkalimin e planeve te parapame. Mandej duhet te perpilohet plani i shperndamjes ku duhet te llogariten mire nevojat e sipermarrjeve, menzave, spitaleve, internateve, institutave dhe per çdo familje. Gjithashtu asht e nevojshme me i sigurue magazinat e pershtatshme per ruejtjen e pemeve dhe te zarzavateve, ne menyre qe keto te ruhen nga te ftohtit dhe nga prishja. Shtabet nuk duhet te lejojne kurrfare stihije ne pune, por te luftojne qe çdo detyre te zgjidhet simbas planit perkates.

Per sa i perket sigurimit te druve asht e nevojshme qe sa ma pare t'organizohet prenja. Keto do te japin ndihme te madhe komunit e [illegible]. Drejtorati i pyjeve i keshillit Krahinuer ka marre persiper me i [illegible] burimet dhe me i caktue vendet e prenjes. Organizimin e punes dhe sigurimin e mjeteve te transportit duhet t'a bajne shtabet perkatese.

Asht per te vue ne dukje se [illegible] sindikale te Keshillit Krahinuer dhe te qytetit Prishtine e kane fillue me ka he pregatitjen e druve, perveç pjeses qe do te sigurohet ne pergjithesi.

Sigurimi i rezervave t'ushqimit dhe i druve do te behet pa tjeter ashtu si duhet ne qofte se te gjitha organet e furnizimit dhe shtabet perkatese, perveshen punes me seriozitet ma te madh dhe luftojne ngutjen per kryemjen me plan te çdo detyre. Per kete pune egzistojne te gjitha mundesit objektive e suksesi do te arrihet nga organizimi i mire i punes dhe nga pergjegjsia e organeve te ngarkuemit me kete detyre.

Furnizimi i parregullt i puntoreve te minieres „Kosova"

Ne minieren „Kosova" puntoret ende furnizohen pa rregull. Keshillat popullore te vendeve me vonese shperndajne triskat e furnizimeve per puntore. Deri me 7 shtatuer sherbimi furnizues per puntore ka marre triskat e furnizimit vetem nga dy keshilla vendesh, gja qe influencon ne blemjen dhe shperndamjen e gjanave ushqimore. Gjate dy muejve te fundit asht permiresue furnizimi me peme, zarzavate dhe mish, ndersa sheqeri, bylmeti dhe sapuni kane arrijte parregull. Keshtu qe sheqeri i muejit te kaluem ka fillue te shperndahet ne keto dite. Ket muej asht vonue edhe gruni, me gjithse „Zhitopromet" i Prishtines asht dashte qe sasin e grunit t'a dergonte qysh me daten 7 shtatuer.

Per pregatitjet e gjanave ushqimore per dimen dhe vendosjen e artikujve te ndryshem ushqimore nuk jane sigurue magazinat e nevojshme. Drejtorija e minieres duhet qe te gjeje mundesit e ngritjes se magazines dhe shtalles per gjane e ekonomis te minieres.

Furnizimi ne tekstil e mbathje nuk i plotesoni nevojet e puntoreve. Pelhura per veshje te mbrendeshme, si dhe pelhura e holle per fustane grash mungon. Keto dite depoja e pergjithshme i ka dergue kesaj minjere 900 pale veshje te mbrendeshme mendafshi per gra, nga te cilat nuk mund te shiten as 100 pale. Rrobe pune dhe kepuce, per te cilat tash per tash ndihet ma teper nevoje, ende nuk jane dergue.

PUNISHA PEROVIQ

Fronti popullor mbas Kongresit te Peste te PKJ

Çdo etape e re e luftes se vendosjes kunder imperjalizmit, siç na tregon eksperjenca e deritanishme e levizjes revolucjonare ne bote lindi ne menyre te paevitueshme forma te reja t'organizimit te masave, „bollshevizmi dhe shumllojshmerija e formave politike" (Lenjini), te cilat i sherbejne klases puntore per realizimin e qellimeve te saja historike. Asht detyre e partis revolucjonare te klases puntore qe t'i çfrytzoje dhe drejtoje si duhet te gjitha keto forma t'organizimit te masave, t'i udhëheqe ato keshtu qe, tue i[illegible] verpimtarin e tyne qellimit kryesor, te mundet me luejte rollin e udhehegjes te turmave punuese ne lufte per socializem.

Lenjini thote: „Vetem me avangarden nuk mund te fitohet. Me e hjedhe vete avangarden ne luften e vendosun, derisa e tane klasa, derisa turmat e gjana nuk i kane marre pozitat osë perkrahjet direkte t'avangardes, ose, se paku qellimet e mira te neutralitetit ndaj saje... do t'ishte jo vetem marri, por edhe krim. Por, qe me te vertete e tane klasa, qe me te vertete turmat e gjana punuese te shtypuna prej kapitalit te vijne deri ne kete pozita, nuk asht e mjaftueshme vetem propaganda dhe agjitacjoni. Prandaj asht e nevojshme eksperjenca e ketyne masave. Ky asht ligji kryesor i te gjitha revolucjoneve te medha..." (Vepra, libri XIV, faqe 250).

Ne baze te kesaj eksperjence te vet masave, mbi te cilen flet Lenjini ne procesin e luftes kunder fuqis se kapitalit dhe llumit reakcjonar te çdo lloji, lindin organizata e masave te cilat, para dhe mbas marrjes se pushtetit nga ana e popullit punues, i sherbejne Partis Komuniste per udheheqjen me sukses te turmave ne luften e tyne per socializem.

Imperjalizmi njikohesisht me te gjitha produktet e veta perfaqson nji perbindsh te tille, i cili e rrethon jo vetem klasen puntore, por edhe te gjitha shtresat tjera punuese: katundarin punuese, mikro-borgjezin e qytetit, intelegjencen, zejtaret etj. Ai sillet brutalisht ndaj pamvarsis kombetare te disa vendeve, e perforcon shtypjen kombetare, shkaton luftera, i rrezikon frytet e punes njerzore dhe te kultures humanitare. Kur t'i shtohet ketij, bankrotizmi i parllamentarizmit dominuese borgjeze te sprovuemit, servilizmi i tyne para kapitalit dhe tradhtia s'interesave kombetare, atehere asht e kuptueshme se pse turmat ma te gjana te nji vendi jane te drejtuemme kah bashkimi ne frontin e perbashket per mprojtjen e interesave te tyne jetesore, ne lufte per nji jete ma te mire. Ne luften e vet kunder imperjalizmit botnor dhe agjentave te tyne ne vendin t'one, ne vjetet revolutare ne pragun dhe gjate luftes se dyte botnore, popujt t'one kane krijue pa dyshim formen e tille te re t'organizimit politik e pershtatshme qe ne rrethanat e veta t'i mbedhe te gjithe elementat antiimperjalista, antifashista, demokratike dhe perparimtar te vendit.

Tue ndjeke ne doktrinen marksiste-Lenjiniste mbi rolin e organizatave masovike, Partija Komuniste e Jugosllavis qysh ne kushtet e Jugosllavis se vjeter te Versajes ka ka bye [illegible] t'organizatave se tille masovike—politike, detyre asht fronti popullore. Natyrisht, kete gja Partija ka marrje me e krye vetem sepse edhe vete asht perfaqsue ma perpara, asht mbeshtetune ne menyre organizative dhe politike ne [illegible] politik i punuesve. Referati i shokut Tito ne Kongresin e Peste te PKJ-se e tregoi kete rruge te veshtire, por edhe te lavdishme te perforcimit dhe te rritjes te rolit te Partis s'one Komuniste.

Tue mos u-rrejte me iluzjonit mbi politiken e spindrave t'udhëheqjeve partive ligalizate borgjeze dhe katundare ne Jugosllavin e vjeter, te cilat kane qene t'interesuese fund e krye me ideologjin reakcjonare, me shovenizmin dhe kapitalin para se drejtimave, Partija Komuniste merr rrugen e formimit te frontit popullor nga poshte, rregon e aktivizimin direkt te turmave rreth programit, te cilin ma dhe Partija kedyne turmave, rreth problemeve ma te ngutshme te jetes s'one politike dhe ekonomike.

Natyrisht, kjo nuk e ka perjashtue punen me krenet e partinave te tjera, krenja e tyne ne Frontin popullor ka pase edhe suksese pjeserisht. Por, puna me turmat, aktivizimi i ketyne turmave rreth çashtjeve konkrete ka pase si perfundim demaskimin e berthames reakcjonare te politikes s'udheheqjes se partinave borgjeze dhe mikroborgjeze, e njikohsisht grumbullimin e masave dhe t'antarve te partinave te tjera rreth Partis Komuniste. Krahas me kete, eksperijenca tregoi se kjo asht rruge ma e sigurte per sigurimin e rolit udheheqes te Partis Komuniste ne Frontin popullor, aleatin e forte te klases puntore dhe te katundaris.

Keshtu pra, qysh ne kushtet e Jugosllavis se vjeter, u-formue levizja e fuqishme popullore, e cila me 27 mars te vitit 1941 e pengoi tradhtine kombetare, e shpetoi nderin e popujve t'one, e me kete gja e cuijti Jugosllavin per Frontin e koalicjonit demokratik antifashist ne krye me Bashkimin Sovjetik — me gjithe qe nuk kete— gja disa mundohen me ma te ne per gabim, simbas nji logjike te mbrapshte.

Asht e kuptueshme se lufta e madhe Nacional-Çlirimtare e popujve t'one, te cilen e ka inspirue dhe organizue Partija Komuniste e Jugosllavis, perhapson lumen e re te sprovimit te vijes politike te Partis, e ne [illegible] te tjerave edhe ate te Frontit popullor. Avangarda nuk ka mujte me shkue vet ne lufte, asht dashte me formue dhe perforcue ate baze, ne te cilen do te zhvillohesh revolucjoni popullor ne kushtet e luftes Çlirimtare; kurse kushtet nuk ishin pjeke, simbas mendimit te disave ne boten e jasht e. Grindja e thelle kombetare, e trashigueme nga katuremja, te cilen okupatori e formoi dhe e zhperson, terori i pashoq i okupatorit, rezistenca e pergjithshme e klasave reakcjonare, te cilat ishin mbeshtetje n'armen e okupuesit, propaganda e vazhdueshme nga bota e jashtme kunder luftes s'armatosun — te gjitha keto e kane veshtiresue mobilizimin e turmave ne lufte, gja qe ka sjelle pasivizimin dhe perçamjen e tyne.

Por, organizimi i forte i Partis Komuniste, guximi dhe rezistenca legjendare e udheheqsis dhe kuadrave te saje, vija e drejte politike ne çashtjen e luftes çlirimtare dhe perspektiven e zhvillimit te saje, ne çashtjen kombetare dhe ne te tjerat, siguruen zhvillimin me sukses te kryengritjes aktivizimin gjithnji ma te gjane te turmave te te gjithe popujve te Jugosllavis — pa marre parasysh perkatsin e tyne te perparshme politike, kombetare ose fetare. Aktivizimi i turmave ne luften e armatosun ka pase si rezultat diferencen e thelle mbrenda partinave te vjetra borgjeze dhe mikroborgjeze, mbrenda te gjitha shtresave te popullit. Nderesa turmat me tharjen dhe me udheheqjen e Partis Komuniste kane marre pjese vullnetarisht ne lufte, mund te thuhet se nji pjese e vogel e udheheqsave te partinave te vjetra t'orjentueme nga demokracija — te cilat se ato kane egzistue ende si organizata politike te njitur llojit — ka shkue mbas ketyne turmave, ka marre pjese ne Frontin çlirimtar. Nji pjese tjeter reakcjonare kyni ne menyre te hapte n'anen e kontra-revolucjonit, n'anen e okupuesit te kundert.

Por, Fronti popullor ne fronte nacional-çlirimtar, ne nji qashje ne kohen e luftes, asht forcue dita dites. Tash ne lufte se ka pase detyre te reja. Berthama e tij ka qene klasa puntore dhe prisneja e saje Partija Komuniste, rreth se cilave jane bashkue te gjithe elementat demokratike dhe patriotike te vendit. Pa Frontin nacional-çlirimtar nuk do t'ishte i mundun realizimi i detyres se madhe historike: çlirimi i popujve te Jugosllavis prej te huejve, permbysja e pushtetit te borgjezis dhe te pronareve te medhej, fillimi i transformimit socjalist te vendit. Ketu bahet fjale mbi faqit'e mbrendshme te zhvillimit, tue mos i harrue me kete rast te gjitha kushtet e jashtme objektive te pershtatshme dhe ndihmen, te cilen ia ka dhane popujve te Jugosllavis Bashkimi Sovjetik dhe Armata e Kuqe e tij e lavdishme — çlirimtarja e njerzimit nga murtaja fashiste.

Fronti popullor gjate luftes u-krijue ne disa vende te Jugosllavis ne menyra disi te ndryshme. Ndersa, per shembull ne Slloveni e edhe ne disa krahina te tjera ka pase edhe elementa te koalicjonit te grupeve te ndryshme, ne vendet e tjera te Jugosllavis u-zhvillue si organizate e pergjithshme masovike-politike e popullit nen udheheqjen e Partis Komuniste te Jugosllavis,-si ne rastin e pare ashtu edhe ne te dytin me program te dukshem lufte te çlirimit. Por, si ne rastin e pare ashtu edhe ne te dytin asht marre si fakt i pamohueshem roli udheheqes i Partis Komuniste. Ne te vertete ne qofte se i jane bashkue Frontit popullor disa grupe politike si grupe, prej tyne asht kerkue qe formalisht dhe me vepra t'a njofin rolin udheheqes te Partis Komuniste. Por evenci e te gjithave ka qene fakti se asht formue organizata masovike e tipit unik, udheheqsit e se ciles, me pak perjashtime, nuk jane zgjedhe me principin e pasimit te Partis, por ne baze te besimit te turmave, per te cilin rast komunistat ma se shpeshti, me pa-merita, e kane fitue kete besim.

Mbas çlirimit te vendit, Fronti popullor ne bazen e vet e ka ruejte karakterin e vet te perparshem, prandaj nuk mund te thohet se ai nuk e ka jetue evolucjonin e vet. Me çlirimin e vendit, para klases puntore dhe Partis Komuniste, e prandaj edhe para Frontit popullor jane parashtrue detyre te reja. Per nji kohe sa ma te shkurte asht dashte me'e perforcue pushtetin popullor demokratik, me i rindertue rrenimet dhe me marre kursin per transformimin socjalist te vendit.

Ne keto kushte Fronti popullor asht dashte me i perforcue edhe ma teper radhet e veta, te bahet organizate edhe ma e bashkueme e turmave punuese, te cilat e ndertojne socjalizmin. Shoku Tito ne Kongresin e Dyte te Frontit popullor te Jugosllavis, tha:

"Rregullimi i ri shoqnuer ne Vendin t'one kerkon edhe formen e re te jetes politike.

Jo vetem struktura politike, por edhe struktura ekonomike e vendit t'one e ban te pamundun egzistimin e shume partive politike me programe dhe kuptime te vjetrueme.

Programi i bashkuem ekonomik kerkon edhe unitetin e Partis".

Po ne te njajtin referat, thuhet:

"Frontet popullore... vetem ne ate rast mund te jene me nji rendesi te plote per zhvillimin e mbrendshem ne çdo vend, ne qofte se transformohen gradualisht ne nji organizate te bashkueme te te gjithe popujve me qellim te zgjidhjes efikase te te gjitha problemeve politike, ekonomike, shoqnore, kulturore etj. ne vend".

Ne te vertete e tille ka qene vija e zhvillimit te Frontit t'one popullor.

Me pushimin e gjendjes se luftes u-zgjidhen shpresat e reakcjonit te permbysun per kthimin e pozitave te tyne t'eksnomi dhe ne jeten politike. Kto shpresa ne nji mase te plote jane ngjalle prej reakcjonit imperjalist te perendimit. Nderesa sporzia reakcjonare borgjeze e mbeshtetjes "sporzia demokratike" se krye me Shubashiqin, Grolin, Shutejin dhe te tjerave, ka pase rol qe me ndihmen e jashtme t'a shkatrroje Frontin popullor, perfaqsuesi i borgjezis se katundit dhe shpresa e reakcjonit, Dragoljub Jovanoviqi e ka marre mbi vehte per detyre me e minue perbrenda unitetin e Frontit popullor. Por, me historin e tane te zhvillimit te vet dhe me rolin udheheqes te Partis Komuniste ne te, Fronti popullor ka qene i gatshem dhe mjaft i fuqishem me i qitue hesapet me ojenin e brendshem armik dhe me i futë me te shpejte ne varrin e politikajve te vdekun.

Keshtu, kjo organizate masovike politike ne Vendin t'one asht spastrue e unifikue dhe ka marre fizionomi gjithnji ma te caktueme. Nderesa ate kohe shkeputeshin bashkunihetaret, e perkohshem, reakcionaret dhe spekulantat politik, ne te kane hye me maja antare te ri te fuqishem.

Na nuk pretendojme qe Fronti popullor asht njifare çpikje e Jugosllavis s'one. Ai asht pjelle e kushteve njikohtare te luftes kunder imperjalizmit. Por, po e tepruem mund te thohet se Fronti i jone popullor mund te sherbeje si model i bashkimit te turmave, i bashkimit koalicjonit dhe t'organizimit te klases puntore dhe te shtresave te tjera punuese dhe demokratike, gja qe asht merite ekskluzive e Partis s'one Komuniste. Ky bashkim ka rendesi te posaçme bash sot, ne periudhen e ndertimit te socjalizmit ne Vendin t'one e aq ma teper mbasi pjesemarrja ne Frontin popullor ne praktike koordinon aktivitetin per realizimin e Planit pesvjeçar, per ndertimin e socjalizmit.

Shoku Kardel ne referatin e vet te mbajtun ne Kongresin e Peste te PKJ-s, thote:

"Kushtet specifike, ne te cilat u-zhvillue dhe zhvillohet revolucjoni i jone popullor-lufta kundra okupatorit per çlirimin kombtar-i dhane bashkimit te klases se proletarjatit dhe njerezve te tjere punues gjanesin e madhe masovike dhe forcimin e posaçem organizativ, e cila çfaqet ne Frontin popullor. Ky fakt e lehteson ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one, e shpejteson ritmimin e tij, i izolon ma tepet elementat kapitalista prej turmave popullore dhe u a hjeke perkrahjen ma te qendrueshme dhe masovike nga ana e çdo shtrese te popullit punues".

Asht e pamohueshme se Fronti i jone popullor simbas perbamjes se klases nuk asht organizate e bashkueme. Ne te asht perfshi: klasa puntore, katundarija punuese, intelegjenca popullore dhe elementat e tjere punues dhe patriotike te Vendit. Ndersa, asht fakt i pakundershtueshem qe kritikuesit t'one ne boten e jashtme e ne radhe te pare shoket pergjegjesa ne partit komuniste motra te vendeve, qe shkojne ne rrugen e socjalizmit nuk e kane kuptue esencen dhe karakterin e Frontit t'one popullor. Nga kjo ka marre nji egji qe ne Rezolucjonin e njoftimit te Byros Informative. Fronti i jone popullor asht pershkrue simbas pasqyres se fronteve popullore te disa vendeve te tjera te demokracis popullore, me gjithe qe Fronti i jone popullor simbas bashkimit organizativ, simbas monolitetit te mbrendshem, simbas koshjences s'antareve te vet, simbas pasteritis politike te radheve te veta, i ka shum larg prej ketyre fronteve popullore ne vendet e tjera te demokracis popullore.

Para se gjithash ne kritiken e Byros Informative parashtrohet qe se permbyset fakti kryesor qe ne Frontin t'one popullor nuk egzistojne partit dhe grupet e ngatrrueme, te cilat me pozitat e punojne t'organizimeve te veta do t'i mprojshin interesat e shtresave sociale te ndryshme ne Frontin popullor; dhe kjo jo vetem sepse dikush i ka ndalue me dekret keto partina dhe grupe, por sepse i ka likuidue jeta, se ne procesin e luftes revolucjonare i ka zavendesue organizata e bashkueme e popullit punues — Fronti popullor. Natyrisht, Partija Komuniste bau perjashtim, e cila parti i çfaqe dhe i mpron interesat si te klases puntore ashtu edhe te njerzve te tjere punues, dhe e cila, si fuqi kryesore organizative, e mbajti rolin udheheqes te te gjithe njerzve punues te Jugosllavis, te bashkuem ne Frontin popullor. Mandej, asht qeshareke me fole mbi „tregtaret", „fabrikantat e vegjel", „kulaket" etj. si per nji faktor serioz ne Frontin t'one popullor, e aq ma teper, kur dihet se te na te gjitha fabrikat, e, edhe ma te vogiat, e gjithe tregtija ka kalue ne pronen e popullit, kurse kulaket gjinden nen [illegible] e vazhdueshem te masave te Qeveris dhe Partis s'one.

Ne qofte se ka elementa armiqe mbrenda Frontit popullor, te armatosun me urrejtje ndaj ndertimit te socjalizmit ne Jugosllavin e re, keta jane disa individe te venmuem, e t'inferm, te cilet rritmi dhe suksesi i ndertimit t'one socjalist do t'i detyroje qe te zhduken shpejte ne kete ase n'ate menyre. Elementat e tille spastrohen e do te spastrohen vendosmenisht ne t'ardhshmen nga radhet e veta prej antarve t'one te Frontit. Keshtu, Fronti i jone popullor — siç asht theksue ne programin e PKJ-s — asht transformue „n'arme te fuqishme kunder influences dhe parez shkatrrimtare te klasave te permbysuna eksploatuese dhe agjentave imperjalista te ndryshem ne turma."

Kritikuesat t'one, tue te mbajte skemave, duen me i harrue faktet qe turmat themelore te popujve t'one e kane kalue shkollen e veshtire dhe t'ashper te luftes çlirimtare, gja qe padyshim asht çfaqe ne vetedijen e tyne. Puna kolosale edukuese ideo-politike, te cilen e ka ba dhe e ban Partija Komuniste, ngritja e vazhdueshme e koshjences politike te turmave dhe edukimi ne frymen e socjalizmit — te gjitha keto Frontit t'one popullor i dhane karakterin e unitetit relativ, te spastrimit dhe te stabilitetit.

Fronti i jone popullor ne tanesi si organizate e turmave ma te gjana punuese, organizate e te gjithe popujve t'one, e pranon programin e Partis, programin e ndertimit socjalist te Vendit; dhe jo vetem qe e pranon, por lufton aktivisht per realizimin e tij. Athere pa fakat e permendura do t'ishin te mundura ato sukseset gjiganteske te realizuemi ne Vendin t'one, te cilat kane shkaktue mrekullima ne bote, athere do t'ishte e mundun shpejtesija e punimit ne rindertimin e qyteteve dhe te katundeve, te bezarullimit ne rinis, te fabrikave dhe ndiacere te reja, te cilave i jane kushtue me miljona dite pune dhe miljarda dinare nga antaret e Frontit t'one, qe te dhane atdheut, perveç punere te tyne te rregullta?

N'etapen e tashme te zhvillimit te Frontit popullor u-krijuen kushte per ngritjen edhe ma te madhe te koshjences se turmave frontiste, per edukimin e tyne edhe ma te madh ne frymen e socjalizmit, ne frymen e klasave te nalta marksiste-lenjiniste. Nga kjo kuptohet randesija e madhe e studimit te marksizem-lenjinizmit — ne baze sullnetare — studimi i veprave te Marksit, Engelsit, Lenjinit e Stalinit ne kuadrin e organizatave te Frontit, te cilat i ka organizue Partija e jone dhe i cili i konsiderohet si nji prej detyreve te rregullta t'organizatave te Frontit.

(Vazhdon ne numrin 148)

ARSIM E KULTURE

Per regjistrimin e nxanesve ne klase t'ulta dhe te nalta ne gjimnazin e Prishtines

Sivjet gjimnazi shqiptar i Prishtines asht i plote d m th. me 8 klase. Tue qene se klasa e VI-te ka aq pak nxanes sa qe nuk mundet me u formue si klase, Drejtorati Arsimuer i ka njoftue drejtorinat e gjimnazeve te qyteteve te ndryshme te Krahines per me i dergue nxanesit shqiptare qe i kane frekuentue mesimet n'e klasen perkatese nder gjimnazet serbe. Edhe po te mos plotsohet numri i dishruem atehere do te pregatiten nxanesit e shkelqyeshem te klases se V-te gjate gjyses se vjetit shkolluer e te kalohen ne te VI-ten.

Persa i perket regjistrimit ne pergjithesi asht per t'u vue ne dukje se deri tash nuk i asht dhane randesija e duhun nga ana e keshillit popullor te qytetit. Me gjithe qe drejtoria e gjimnazit ka intervenue ne seksjonin e arsimit te qytetit per te mbajte konferenca prindesh per regjistrimin e femijve te tyne s'asht ba asgja. Po keshtu, ngjane edhe me seksionin e arsimit te keshillit popullor te rrethit, nga i cili drejtoria e gjimnazit ka kerkue te regjistrohen nxanesit qe e kane krye shkollen fillore nder katunde, mirepo referenti i arsimit deri tash as qe i asht pergjegje akin te drejtoris, e si rrjedhim del qe deri tash s'asht regjistrue asnji nxanes prej rrethit te Prishtines.

Tue u bazue ne regjistrimin e deritashem kemi si perfundim qe pjesa ma e madhe e nxanesve s'asht regjistrue, e sidomos ata te klases se pare. Prandaj, ne beze te rezultateve te punes se deritashme del si detyre qe si keshilli i qytetit ashtu edhe i rrethit t'angazhohen ashtu si duhet qe me ane konferencash dhe me ane te ligjit ti binde ata prinde te femijve per me i regjistrue ne gjimnaz e sidomos femnat qe deri tash jane paraqite kreit pak. Natyrisht, per kete s'ka me mungue edhe ndihma e Frontit popullor dhe e Bashkimit kulturalo arsimuer. S'duhet harrue se edhe ligjerisht shkolla shtatvjecare — kater klase te fillores dhe tri gjimnaz — asht e detyrueshme per te gjithe femijt mashkuj e femna.

E shofim te revoishme qe me kete rast t'ua kujtojme qytetareve shqiptare te Prishtines se pushteti popullor po ban cmos per plotesimin e kushteve ma te mira te shkollimit te femijve te tyne. Sivjet, gjimnazi shqiptar asht plotesue me personelin e nevojshem te mesimit, asht plotesue edhe ma mire me orendi shkollore, jane caktue sallat e bibliotekes, laboratorumit etj. Ata duhet t'a dijne fort mire se shkollimi i femijve te tyne asht drejte per drejte n'interesin e dy paleve dhe t'atdheut t'one, prandaj do t'ishte gabim i rande qe ata mos t'interesohen e cka ma teper t'i pengojne femijt e tyne ne regjistrim.

Pervec te tjerash per regjistrim ka mungue edhe mos-angazhimi i personelit mesimuer, i cili s'ka bisedue me prindrit e femijve per t'i regjistrue ne gjimnaz.

Nga te gjitha keto, pritet qe deri ne fund te muejit te permiresohen te gjitha gabimet dhe te krijohen kushtet, ne menyre qe mos te ngele asnji femij shqiptar me shkolle fillore pa u-regjistrue ne gjimnaz.

Prishtine

Ne riprovimet e nxanesve te rregullte te gjimnazit te Prishtines, prej te cileve kane pase ngele ne seminature 29 prej klases se III-te dhe te IV-te, qe te gjithe u-paraqiten ne riprovim dhe prej tyne kaluen 28. Njeni ngeli per t'a perserite seminaturen.

Detyre t'aferta per Bashkimet dhe shoqnit kulturalo-arsimore ne Krahinen t'one

Qe prej formimit te Bashkimeve kulturalo-arsimore ne shumicen e rretheve dhe nder qytete, ende nuk asht dallue ndonji dukuni e gjalle veprimtarije ne lamen kulturo-arsimore. Bashkimet kulturalo-arsimore ende nuk e kane realizue koordinimin e ngushte me seksjonet e arsimit. Nga kjo ka rrjedhe qe nder disa qytete e rrethe, tue mos u-angazhue antaret e seksjoneve te ndryshme te drejtimit te Bashkimeve, nuk jane krye me kohe as pregatitjet e vazhdimit te likuidimit t'analfabetizmit - detyre ma e afert e tyne. E gjithe kjo pune u asht lane ose seksjoneve t'arsimit, u e mesuesve, te cilet ende nuk kane lidhye ne detyre prej kurseve pedagogjike etj.

Kuvendimi i bashkimeve kulturalo-arsimore asht qe se pari t'i aktivizoje te gjitha seksjonet e ndryshme, domethane qe sejcili antar t'a udheheqe punen e sektorit te tij tue pase detyre konkrete dhe aktuale ne cdo kohe. Mandej ato duhet t'i formojne shoqnit kulturale arsimore nder keshilla vendore dhe nder katundeqe par, atje ku jane kushtet ma te plota e ma t'aferta. Pa formimin e ketyne shoqnive s'mund t'ie arrijet ka unda e ve ndihma e nevojshme e ngritjes kulturore.

Per te gjitha Bashkimet dhe shoqnit kulturalo-arsimore tash per tash paraqiten keto detyre te ngutshme:

a) Ato t'a ndihmojne sa ma shume pushtetin dhe arsimtaret per pregaditjen dhe fillimin e punes se kurseve analfabetike, tue i sigurue kuadrat udheheqese te tyne, ndjekjen e rregullt te mesimeve prej kursistave dhe realizimin e planit ashtu sic asht parapa ne vend etj.

b) T'i organizojne grupet e ndryshme te katundeve e te qyteteve per t'u paraqit ne festivalin Krahinuer, qe do te zhvillohet mbas disa javesh ne Prishtine. Me pase ne konsideracjon qe grupet te paraqiten me kostume karakteristike te vendit dhe me pjese folkloristike origjinale.

c) Me u-perpjeke qe ne garat e n'e ... sejcila shoqni kulturale t'i pajise me libra e t'i mbaje sa ma mire bibliotekat dhe sallat e leximit.

Ne festival duhet te marrin pjese te gjitha rrethet, prandaj asht mire dhe ma se e nevojshme qe te bahen me kohe te gjitha pregatitjet dhe, grupet e festivalit te paraqiten me programe sa ma te pasuna.

T'a ndihmojme javen e Kryqit te Kuq

Edhe sivjet sikurse ne vjetin e kaluem, Kryqi i Kuq e organizon javen e vet, e cila do te filloje me nji tetuer te ketij vjeti.

Organizata e Kryqit te Kuq ne Kosmet ka mbrrijte deritash rezultate te mira ne pune. Ajo u ka dhane ndihme te madhe te mjeruemve, viktimave te luftes, atyne te terorit fashist, shtepijave te femijve, shtepijave te pleqeve, kuzhinave te shkolles, brigadave te punes etj. Kjo ndihme asht dhane qofte me anen e pushtetit popullor, organizatave te rinis, qofte me anen e keshillave te qytetit dhe te rrethit te Kryqit te Kuq, e keto, mandej me anen e keshillave te rejonit e te vendit dhe atij te fillzave.

Ne sektorin e shendetsis ka pase gjithashtu mjaft rezultate. Kryqi i Kuq ka marre pjese ne pregatitjen e akcjoneve, tue i ndihmue organet e pushtetit popullor dhe organizatave te tjera masovike ne pregatitjen e javes se feinis.

Por, pervec rezultateve te mira ne punen e saje, organizata e Kryqit te Kuq ka pase edhe te meta e mungesa. Ajo nuk ka dhane aq sa duhet ne punen e masovizimit t'organizates.

Ne punen e riyjeme te Kryqit te Kuq duhet te perfitojme prej pervojes se mjerrun nga puna e deritashme.

Java e Kryqit te Kuq duhet te jete pasqyrimi i punes se Kryqit te Kuq; ajo nuk duhet te kete karakter manifestues, por duhet te jete jave per mobilizimin edhe ma te madh ne kryerjen e detyrave qe shtrohen para Kryqit te Kuq.

Organizatat e Kryqit te Kuq duhet te nxjerrin planet e veta per organizimin sa ma te mire te javes. Detyra kryesore asht perforcimi i organizates dhe masovizimi i saje me antare te rije, si ne te rritun ashtu edhe ne filiza. Me anen e konferencave duhet me tregue randesin e organizates se Kryqit te Kuq, me u tregue antareve idet'e Kryqit te Kuq me perforcue nderhyrjen e antareve ne lidhjen me organizaten etj.

Java e Kryqit te Kuq duhet t'a ndihmoje gjithashtu organizaten edhe materjalisht. Gjate kesaj jave do te mblidhen ndihma vullnetare, e gjithashtu do te shfaqe ne favor te Kryqit te Kuq edhe t'ardhunat nga cfaqjet e ndryshme kulturale etj.

Per organizimin sa ma te mire te kesaj jave asht e nevojshme me i formue prane te gjithe keshillave te vendit aktivet e vecanta. Me anen e ketyne aktivave me perfshi sa ma shume antare te rij dhe me iu dhane mundesi qe te marrin pjese ne kryemjen e detyrave te Kryqit te Kuq.

Vend me randesi gjate javes zen dita e juniorve, e cila do te mbahet me 2 tetuer. Me tre tetuer do t'organizohet mbledhja e ndihmave dhe dhanija e shenjave prej letre.

Per me e sigurue suksesin e plote te javes, organizatat e Kryqit te Kuq duhet te bashkepunojne ngushte dhe te gezojne ndihmen e organizatave masovike, t'organeve te pushtetit popullor etj.

Nga Bashkimi Sovjetik

Vjeti shkolluer ne Bashkimin Sovjetik

Me 8 shatuer te ketij vjeti ne Bashkimin Sovjetik filloi vjeti shkolluer. Ma se 33 miljone femije, te rij e te reja kane ardhe nder shkolla fillore dhe te mesme, i kane mbushe aullat e universiteteve dhe institutave.

—o—

Nder shkollat fillore, shtatvjecaret dhe te mesmet ne Bashkimin Sovjetik jane regjistrue 32 miljone nxanes. Ky numer asht pese here ma i madh se sa ai ne Rusin para-revolucjonare.

—o—

Shkollat e nates dhe ato te nalta me korespondence i ndjekin sot ne Bashkimin Sovjetik ma teper se nji miljone studenta. Ne semestrin e pare te ketij vjeti jane regjistrue ne 180.000 te rij e te reja. Midis tyne ka edhe pjesemarrsa te luftes se madhe patriotike. Ne shkollat e nalta te Bashkimit Sovjetik ka ma teper studenta se ne te gjitha vendet e Europes.

—o—

Ne BRSS ne vjetin shkolluer 1948-49 do te punojne 197,500 shkolla fillore, shtatvjecare dhe shkolla te mesme. Ne keto shkolla japin mesim 1,278,000 mesues.

Pushtuesat fashista i kane shkaktue dame te mdhaja ngritjes se popullit n'Ukraine. Ne Kijev okupatoret kane rrenue 140 shkolla fillore dhe te mesme. Ne republiken e Ukraines jane ndreqe te gjitha shkollat. Ne ket vjet jane hape edhe 1005 shkolla shtatvjecare dhe te mesme.

—o—

Ne Bellorusi ka 1 miljone e gjysem nxanes. Ne klaset e ulta jane regjistrue 225.000, femij, qe don me thane sa numri i gjitha klasseve te shkollave te Bellarusis para-revolucjonit te Madh te Tetorit.

—o—

Ne Kazahstan, para-revolucjonit ka pase 1985 shkolla fillore, 40 asish shtatvjecare dhe 12 shkolla te mesme. Ne ket republike nuk ka pase asnji shkolle te nalte. Sot ne Kazahstan jane 6052 shkolla fillore, 1690 asosh shtatvjecare dhe 617 shkolla te mesme. Ne keto shkolla i ndjekin mesimet ma se 1 miljone femije.

Ne Kazahstan jane 23 shkolla te nalta dhe 89 te mesme teknike. Ketu asht edhe nji universitet shtetnuer.

—o—

Ne Republiken Sovjetike Socjaliste t'Azerbajxhanit jane 18 shkolla te nalta dhe 37 shkolla te mesme teknike. Shkolla e nalte n'Azerbejxhan numron 6.217 studenta.

Neper fabrika dhe institute asht hape nji numer i madh shkolla natesh per femijt e punetoreve. Keto shkolla i ndjekin 16,000 te rij e te reja.

N'Azerbajxhan para-lufte, ne 100 persona vetem 3 vete kane dijte me shkrue e me kendue.

—o—

Ne Kirgizi para-revolucjonit ka pase 2 perqind njerez qe kane dijte shkrim e kendim.

Gjate pushtetit sovjetik ne Republiken Sovjetike Socjaliste te Kirgizis jane hape 6 shkolla te nalta dhe 25 te mesme teknike. Nder shkollat e Kirgizis punojne sot 12.852 mesues.

—o—

Ne Bashkimin Sovjetik jane botue 106 miljone ekzemplare tekstesh ne gjuhe te ndryshme te popujve te Bashkimit Sovjetik.

—o—

Me inisjativen e kolhozjaneve te Republikes Sovjetike Socjaliste te Rusis, me forcat e veta jane ndertue 291 shkolla katundesh dhe jane tue marre fund ndertimet e 976 shkollave tjera. Kolhozjanet e Bellorusis ne vjetin 1948 kane ndertue 329 ndertesa shkollash. Deri me tridhete e nji vjetorin e Revolucjonit te Madh te Tetorit, kolhozjanet e Bellorusis do te ndertojne 595 ndertesa te tjera shkollash.

AKCJONI KATUND — QYTET

VIZITE E EKIPES SE MJEKEVET N'ISTOK

Te dielen e kalueme, Drejtorati i Shendetsis te Keshillit Popullor Krahinuer organizoi nji ekipe prej disa mjekesh te Krahines s'one — specialista te semundjeve te ndryshme — dhe e dergoi per te vizitue Istokun, mbassi aty s'ka mjek as spital.

Te semundeve me malarije, ekipa ua analizoi gjakun; ketyne dhe te tjereve udha receta te ndryshme, e ata me semundje te rande i dergoi per sherim ne spitalin e Pejes.

Nderkaq, ekipa kinematografike e ndermarrjes „Avala-film" fotografoi pamje te ndryshme gjate gjithe vizites se te semundeve prej mjekeve.

Me gjithse keshilli popullor i rrethit t'Istokut ka qene njoftue nga ana e Drejtoratit te shendetsis dhe e ka dijte mire diten e vizites se mjekeve, prap se prap nuk asht organizue ashtu si pritej: ka ngja qe edhe njerez te shendoshe me u-paraqite per vizite ke mjeket, gja qe ka shkaktue humbje kohe e te ngele ndonji tjeter i semunde pa u-vizitue.

Ne mbramje ekipa e mjekevet kthej ne Prishtine.

Fiskultura dhe Sporti

PRIZREN:

Te dielen me 19 te ketij muej, ne lushen sportive te Prizrenit u-zhvillue nji ndeshje miqsore e vooli-ballit, ndermjet ekipes sportive „Polet" te Prishtines me ate „Metohija" te Prizrenit.

Ndeshja qe e gjalle, sidomos u-dalluen ne Loje Dauti, Suroi prej ekipes mike dhe Bashkim Fehmiu prej asaj vendase. Loja perfundoi 4:0.

(15:2,15:7,15:5 e 15:9) ne favor te „POLETIT".

—o—

PRIZREN:

Mbas ndeshjes se vooli-ballit filloi ndeshja e lojes se lope-kambes ndermjet Sh. S. „POLET" dhe asaj „METOHIJA".

Qe ne fillim loja nisi te bahet e gjalle. Mbas nji zbritjeje te bukur Hasani shenon golin e pare per miqet. Tash loja zhvillohet edhe ma me gjallni. Mbas nji pasi te bukur qe e merr Kukuli, barazon 1:1. Skuadra vendase ban gjithnji zbritje te bukura, por mbrojtja din se largon rrezikun. Dikure, mbas nji pasi qe merr Mustafa, gjuen rrebte prej 20 metrave. Fishici don t'a largoje rrezikun por topi e lekunde rrjeten: 2:1 per skuadren mike, e keshtu merr fund pjesa e pare e lojes.

Ne pjesen e dyte skuadra vendase del me pak ndryshime; lojtaret kane lidhje te mire njeni me tjetrin. Babarogici mbas nji pasi te bukur qe merr prej Kukulit, barazon 2:2.

Tashma qe te dy palet mundohen te japin golin e fitimit, por nuk ia mbrrijne qellimit, sepse topi kalon jashta portes, ase ne duer te portjerit; kane mbete edhe pak minuta qe loja te marre fund, por Kukuli mbas nji zbritjeje te bukur ne porten kundershtare shenon golin e fitimit 3:2 per skuadren vendase. Miqet baine zbritje te njimbasnjishme por s'ia mbrrijten qellimit, dhe loja muerr fund.

Prej skuadres mike u-dalluen Mica, nga ajo vendase Kukuli, Avduli e Jusuli. Loja u-zhvillue ne frymen vllaznore.

PEJE:

Te dielen, me 19 te ketij mueji, ne Peje asht zhvillue ndeshje miqsore ne mes te SH.S. „Sloga" te Shkupit dhe SH.S. „Ardhmenija" te Pejes. Loja gjate gjithe kohes ka qene e gjalle dhe interesante. Ne saje te lojes ma te mire „Ardhmenija" e mujti skuadren mike tue arrijte rezultatin 1:0, me gjithe qe simbas lojes se bukur qe kane zhvillue, rezultati ka mujte me qene ma i mire. Golin fitimtar SH.S. „Ardhmenija" e ka ba nga gjysma e lojes se dyte me anen e Zhivorad Cvejqit. Nga skuadra mike jane dallue per lojen e tyne te mire dy begjet. Nga skuadra e „Ardhmenija" lojtari ma i mire ka qene Ferd Shkjezi' alla i djathe, i cili bani te mundshem arrijtjen e golit te vetem.

—o—

Rezultatet e ndeshjeve ma date 19 te k. m.

Ne Prizren: Metohija (Prizren) — Polet: 3:2.

Novi Pazar: Vllaznija (Prishtine) — Sanxhak (Novi Pazar) 1:1.

Ne Gjakove: Vllaznija (Gjakove) — Luftetari (Ferizaj) 4:1.

—o—

Kampjonati i zones se peste

Me 26. IX. fillon kampjonati i zones se peste, ku marrin pjese tete skuadra. Ne diten e pare te ketij kampjonati do te zhvillohen keto ndeshje:

Ne Mitrovice. — Sh. S. „Trepca" — Ylli i Kuq (Gilan).

Ne Prizren. — SH. S. „Metohija" Prizren) — Polet.

Ne Peje. — SH. S. „Ardhemenija" (Peje) — „Luftetari" (Ferizaj).

Ne Novi Pazar. — SH. S. „Sanxhak" (Novi Pazar) — „Vllaznija" (Gjakove)

—o—

Gjiro ciklistike e Kosmetit

Keshilli fiskultural Krahinuer per Kosmet ka organizue me 17 tetuer gjiron ciklistike, e cila do te bahet ne pjesen ma te madhe te Kosmetit. Gjatsija e rruges se kesaj gjiroje asht 520 kilometra.

Vaprimet do te bahen ne kater etapa, tue fillue nga Prishtina dhe tue kalue neper Mitrovice, Peje, Prizren e arrijtja do te jete ne Prishtine. Ne kete gjiro mund te marrin pjese cdo cikist.

LAJMERIM

Per arsye teknike nuk ka muejt me u-botue numi i gazetes ne diten e ejte.

Redaksija

Populsija e Pejes nuk furnizohet me rregull

Furnizimi i populls se qytetit te Pejes prap nuk bahet me rregull. Artikujt e paraparne per furnizimin e garantuem nuk ndahen ne kohen e caktueme, kurse prodhimet, te cilat bujqit i sjellin ne treg jane te shtrejta. Me gjithse rrethi ka me bollek peme, pervec mollave te tjerat nuk gjinden fare ne treg, per arsye se Bashkimi i kooperativave te rrethit nuk e ka zgjidhe cashtjen e transportit dhe nuk e ka ndihmue ndermarrjen e furnizimeve te qytetit. Per kete arsye, disa ndermarrje ia kane nise ne krye te vetin te mbledhin prodhimet bujqesore per punetoret e tyne, gja qe influencon ne ngritjen e cmimeve.

Jane marre masa qe te permiresohet furnizimi i populsis se qytetit. Asht perpunue plani i porosinave ditore te prodhimet, ne bashkepunim me drejtorin e kooperativave bujqesore te Pejes. Keshilli popullor i qytetit ka sigurue per populsin e Pejes sasina te konsiderueshme qymyri dhe drush per djegie.

Hovi i punes ne brigaden e Frontit populluer te rrethit te Gjakoves ne rrugen Deve - Minjere

Brigada e Frontit populluer te rrethit te Gjakoves, ne te cilen marrin pjese 300 antare te Frontit, asht tue e vazhdue punen me hov te madh, te cilen e ka fillue me 25 te muejit te kaluem. Te gjithe keta, tue pase koshjence dhe bindje te plote se me ndertimin e kesaj rruge do t'i epet mundesija edhe ma teper zhvillimit t'industris ne Vendin t'one dhe, n'asen tjeter do t'u epet mundesija njerezve t'one punues per te marre pjese ne pune, perpiqen me punue sa ma shum.

Qe te gjithe nuk dijne se shka don me thane lodhje, por punojne me energjin ma te madhe. Qe ne ditet e para garat jane te panderpreme. Flamurin kalimtar ne fillim e pat marre çeta e pare e Gjakoves, mirepo mandej e deritash ate e mban çeta e V-te, derisa asht tregue ma e forte ne pune. Shquhen ne pune frontistat Selim Dina, Ali Selmani, Ram Alija, Muharrem Hyseni, Bek Bajrami etj.

Prej fillimit te punes e deri me sot antaret e Frontit ne kete akcjon kaq me randesi kane nxjerre ma se 5,704,76 metra kubik dhe.

Deri tashi jane mbarue se ndertuemi 12 kilometra rrage, domethane se kane ngelo vetem edhe 2 kilometra per t'u krye, e cila sigurisht do te kryhet edhe para premtimit qe ata kane dhane.

Ne brigade asgja s'i lebet mangut edhe punes ideologjike-politike dhe kulluralo-arsimore. Ne secilen çete jane formue grupet e leximit, ku perpunohet materjal nga shtypi i jone i perditshem krahinuer e qendruer.

Me punen e vetmohueshme dhe me koshjence te plote antaret e Frontit te kesaj brigade tregojne se kane qene, jane dhe do te jene te gatshem mos me kursye asgja per rindertimin e Vendit t'one drejte jetes se lumtun per masat t'ona punuese — socjalizmit. Ata i hjedhin poshte shpifjet dhe rrenat e trillueme t'udheheqesinave te vendeve demokratike dhe bashkohen edhe ma fort rreth Partis s'one heroike dhe Komitetit t'one Qendruer me shokun Tito ne krye.

SH. HOXHA

Duhet me e shpejtesue punen rreth kontraktimit te misrit

Me urdhnin e Ministris se tregtis dhe te furnizimit te RFPJ kontraktimi i misrit do te vazhdoje deri me 10 tetuer. Pra, deri n'ate date na mbetet fare pak kohe per t'a krye plotesisht kontraktimin e misrit. Tue e marre parasyshe edhe faktin se ne kete drejtim nuk jane mbrrijte deri tash rezultatet e duhuna, asht e nevojshme qe t'ia hyejme punes ma seriozisht per realizimin e shpejte dhe te plote te planit te kontraktimit. Tue qene se kjo pune nuk mund te shtyhet edhe ma, asht e nevojshme qe te ndermerret nji akcjon i shpejte per kryemjen e kesaj detyre ne kohen e duhen, keshtu qe mbas kohes se caktueme te jemi te lire per plotsimin e detyrave tjera te parapame ne plan.

Kontraktimi i misrit asht tash nji nga detyret ma te randesishme te keshillave populore dhe t'organeve te blemjes. Nga puna e dobet qe asht ba deri tash rreth kontraktimit te misrit, konstatohet se asht nençmue deri diku ky problem qe ka randesi te madhe shoqnore e politike.

Per kryemjen me sukses te kesaj detyre luen rrol te randesishem edhe te çmuemit e shpejte e te drejte te prodhimit te misrit. Ne disa rrethe nuk asht krye si duhet as kjo detyre. Ne te çmuemit e prodhimit jane perserite disa gabime qe jane konstatue me rastin e te çmuemit te prodhimit te drithnave te bardhe. Ne disa rrethe prodhimi asht çmue nalt e ne disa te tjere teper poshte. Ne disa rrethe nuk jane ba perpjekjet e duhuna per zbulimin e te gjitha siperfaqeve te mjelluna me miser. Per me muejte me i evitue te gjitha gabimet dhe te metat, Drejtoratj i tregtis i Keshillit Krahinuer ka organizue ekipa dhe i ka dergue ne terren; ne komisjone jane tue marre pjese vete sekretaret e kryetaret e keshillave te vendeve.

Tue e marre parasyshe se tash ka fillue korrja e misrit ne shumicen e rretheve, asht e domosdoshme me e perfundue sa ma pare te çmuemit e prodhimit individualisht per çdo prodhues, keshtu qe atyne t'iu epet mundesija me i kontraktue jo vetem tepricat e detyrueshme, por edhe tepricat e lira, e ne kete menyre t'i çfrytezojne te gjitha te mirat e Dekretit perkates (25% te holla ma teper, bonat perkates per blemjen e artikujve industrijal me çmime t'unjisueme ma t'ulta etj).

Para te gjitha organizatave masovike dhe organeve perkatese te blemjes shtrohet detyra e bashkpunimit ma te ngushte dhe ndihmes se madhe per kryemjen me plan dhe me kohe te kesaj detyre te randesishme per sigurimin e fondit t'one te drithit, per sigurimin e ushqimit te popullsis puntore punuese.

—x—

Veprimtarja e sipermarrjes se ndertimit „Shtedim" ne Peje

Sipermarrja e ndertimeve «Shtedim» ne Peje ka parapa ne planin e vet te ndertimit qe ne ket vjet te ndertojne 47 objekte te reja. Prej ketyne dy jane me randesi te pergjithshme, 18 me randesi republikane dhe objektet tjera jane me randesi lokale. Deri ne fund te vjetit, kjo sipermarrje do te ndertoje ndertesen e deges se bankes popullore ne Gjurakove, ndertesen e magazines ushtarake ne Peje, 6 ndertesa per nevojat e pasunis bujqesore ne Vitomerice, tri ndertesa te stacjonit te makinave dhe traktoreve ne Peje. Perveç kesaje do te ndertoje edhe tri magazina dhe ndertesat e pasunis se pyjeve ne Peje.

Prej objekteve me randesi lokale, kjo sipermarrje do te ndertoje disa furra tullash e tjegullash, ne Peje, 7 ndertesa per nevojat e fermes se kafshëve ne Gjakove, ndertesen e shkollës se frutikulturës, ambulanten e veterinaris, ndertesen e shtepis se femijve dhe te dispanzerit anti-tubekuloz ne Peje. Perveç ketyne, do te ndertohet stacjoni sanitar dhe do te perfundohet ndertesa e gjimnazit ne Gjurakove si dhe shtalla per kafshe ne Deçan.

—o—

ZVEÇAN:

Tue luftue per produktivitetin sa ma te madh ne shkrijtoren e plumbit dhe te xingut ne sipermarrjen e Zveçanit, treshja punuese e perbame nga puntoret Bajram Salihu pese here sulmues; Ymer Muharremi dhe Rexhep Rexhepi tri here sulmuesa e kalojne normen rregullisht per 25 per qind dhe kursejne ne djegeje 3 per qind te koksit.

Nga situata nderkombtare

Seanca e Trete e Asambles se pergjithshme t'Organizates se Kombeve te Bashkuem

(Artikull nga revista „Novoje vremja")

Revista „Novoje Vremja" botoi kryeartikullin me titullin „Ne lidhje me Seancen e trete t'Asambles se pergjithshme t'OKB, ne te cilin thuhet:

Organizata e Kombeve te Bashkueme nuk ka mujte me i justifikue ato shpresa qe i kane pritë popujt paqedashes nga kjo Organizate. Bilanci i veprimtaris se saje asht vështirë sue me nji shumice lëshimesh serjoze dhe vendimesh te gabueshme te marruna pa shqyrtimin e nevojshem, te cilat e kane minue mjaft autoritetin e saje. Kuptohet se keto gabime nuk jane te rastit: Ato jane rrjedhim i politikes koshjente te fuqive te caktueme, te cilat veprojne ne kuadrin e OKB. Ekspansionistat amerikan, te pushtuem me idea e pakuptim te hegjemonis botnore kane marre rrugen e transformimit t'OKB nga arma per perforcimin e bashkepunimit nderkombetar, sigurimit te paqes dhe sigurimit te popujve ne nji arme te politikes imperjaliste te Volstritit, tue u perpjekë me e sjelle kete Organizate ne aberrën te qellimeve te veta agresive. Shtetet e Bashkueme t'Amerikes dhe vendet, te cilat i nenshtrohen blokut Anglo-Amerikan, nuk kursehen nga fyemjet direkte te Kartes se Kombeve te Bashkueme dhe nga ndryshimet brutale te principeve, mbi te cilat asht ndertue ajo.

[illegible]

Nuk besohet se nevojiten prova tjera ma bindese qe politika e ignorimit te Bashkimit Sovjetik ne punet nderkombetare, ignorimi i t'interesave te tija jetsore dhe te kerkesave te drejta, nuk sjelle dhe nuk mund t'i sjelle iniciatorve te vet kurgja te mire. Popujt po shofin ngadhadi se kush po lufton me te vertete n'organizaten e Kombeve te Bashkueme per interesat e paqes se qendrueshme dhe kush po orvatet, qe nen flamurin e paqedashës, t'i rregullojë punet e veta imperjaliste. Asht veshtire me e gjete sot nji njeri naiv qe te besoje se propozimi Anglo-Amerikan mbi revizionin e Kartes kundra te cilit luftojne Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera demokratike, diktohet me kujdes per perfeksionimin e OKB ose per ngritjen e autoritetit te saje dhe perpikmenis s'akcioneve te saje. [illegible]

[illegible]

Opinioni demokratik i mbare botes [illegible] Seancen te trete te Asambles pergjithshme. [illegible]

[illegible]

LUFTA E POPULLIT GREK

Manevra ofensive e njisive t'Armates Demokratike ne sektorin Murgan - Zagorje

ATHINE:

Radio stacjoni i Greqis se lire lajmoi referatin e Shtabit Madhnor te Armates Demokratike mbi operacjonet ne sektorin Murgan dhe Vici. [illegible]

[illegible]

—o—

Bullgarija ka perserite deshiren qe te pranohet ne OKB

[illegible]

—o—

Kthimi i grupit te fundit te nxanesve jugosllav nga Praga

PRAGE:

[illegible]

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Miladin Popoviq" Prishtine.
Pajtimet ne Detoren i pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906030.